



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

STATUTI i

Bashkimit Demokratik për Integrim

(teksti i konsoliduar)

Shkup, 05, qershor 2014



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

Konform nenit 3,14 dhe 16 të Ligjit për parti politike („Gazeta zyrtare e RMsë,, nr 75/2004,5/2007,7/2008 dhe 23/2013) dhe përcaktimeve programore të BASHKIMIT DEMOKRATIK PËR INTEGRIM, në Kongresin III të BDI-së, mbajtur më 05.06.2014 në Tetovë, ndryshoi dhe plotësoi:

STATUTIN

E BASHKIMIT DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Statut, rregullohen emri i partisë, emblema dhe selia, përfaqësimi, anëtarësia, të drejtat dhe përgjegjësitë, format e organizimit dhe të veprimit, procedurat për zgjedhje, forumet e saj, financimi, kushtet për ndërprerjen e veprimtarisë, si dhe çështjet e tjera me interes për anëtarët e saj dhe partinë.

Neni 2

Bashkimi Demokratik për Integrim është parti politike e pavarur dhe e hapur për të gjithë qytetarët, për të arritur objektivat e përcaktuar, në bazë të programit, statutit dhe akteve të tjera.

Neni 3

Emri i partisë është: Bashkimi Demokratik për Integrim. Shkurtesa e emrit të partisë është: BDI.

Neni 4

Selia e partisë është në Shkup; Rr. “Pançe Nedellkovski” nr. 47

BDI ka cilësinë e personit juridik.



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

Neni 5

BDI ka emblemën, flamurin dhe himnin e vet, të cilat i përcakton Këshilli i Përgjithshëm.

Pamja e emblemës paraqet figurë rethore e stilizuar, përreth së cilës është shënuar emri Bashkimi Demokratik për Integrim dhe në pjesën e poshtme janë vendosur shtatë yje nga të cilët njëri yll është i stilizuar në rreth, në mes së cilës janë shënuar shkronjat B, D, I, mbi të cilat janë vendosur shtatë yje, nga të cilët njëri yll është i stilizuar në rreth.



Flamuri i partisë ka formë të katërkëndëshit, me ngjyrë të kaltër me dimensione 1:2, kurse në mes qëndron emblema e partisë.

Neni 6

BDI ka vulë në formë rrethi dhe vulë katrore.

Vula e partisë ka formë të rrethit me diametër 3 cm, në të cilën në gjuhën shqipe dhe maqedonase është i shkruar emri i partisë dhe selia e saj, kurse në brendi është e vendosur emblema e partisë.

Në vulën katrore me dimensione 6x3 cm është i shkruar emri i partisë në gjuhën shqipe dhe maqedonase dhe selia e saj, vendi për datë dhe numër protokolli, kurse në pjesën e këndit të majtë qëndron emblema e partisë.

Partia ka llogarinë rrjedhëse të saj.

II. ANËTARËSIMI NË PARTI

Neni 7

Anëtarësimi në parti është i lirë dhe vullnetar.

BDI është e hapur për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë. Anëtar i BDI-së, mund të bëhet çdo qytetarë i R. së M-së mbi moshën 18 vjeçare, i cili pranon Programin, Statutin e partisë si dhe deklaron dhe plotëson fletëregjistrimin për anëtarësim në parti.

Në parti nuk mund të anëtarësohen personat që janë anëtarë të partive të tjera politike dhe të organizatave të tjera, të cilat bëjnë luftë për pushtet.

BDI mund të ketë edhe anëtarë nderi.



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

Anëtarët e nderit, me propozimin e Kryesisë të Këshillit të Përgjithshëm i shpall Kongresi, kurse midis dy kongreseve i shpall Këshilli i Përgjithshëm i BDI-së.

Neni 8

Anëtarësimi në parti realizohet pranë organit më të afërt të vendit të partisë, ku jeton personi.

Anëtarësimi bëhet në këshillat vendorë, nëndegët dhe degët e partisë

Neni 9

Mënyrën e anëtarësimit në formë të shkruar, anëtarësimi elektronik, si dhe mbajtja e regjistrit të anëtarëve, rregullohet me rregullore të veçantë.

Neni 10

Anëtarësimi në parti pushon me:

- tërheqjen e fletë-anëtarësimit me deklaratë të posaçme në mënyrë vullnetare;
- me mospagesën e anëtarësisë së rregullt vjetore;
- me humbjen e aftësisë psiko-fizike për veprim politik;
- me përjashtim nga radhët e partisë;
- me vdekje;

Neni 11

Anëtari përjashtohet nga partia kur shkel Programin ose Statutin e partisë, bënë keqpërdorimin e mjeteve materiale dhe financiare, bie në kundërshtim me aktet juridike të partisë, si dhe për veprimet e pamoralshme dhe komprometuese që dëmtojnë prestigjin e partisë.

Neni 12

Përjashtimi nga anëtarësia bëhet me vendim të Kryesisë së Degës, ku është i anëtarësuar personi ose të organit të partisë ku bënë pjesë si i zgjedhur.

Neni 13

Personi i përjashtuar ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh, pas vendimit për përjashtim.

Ankesën mbi vendimin për përjashtim e shqyrton Komisioni i Shkallës së Dytë, i formuar nga ana e Këshillit të Përgjithshëm.

Neni 14

Anëtar nderi të BDI-së, mund të bëhen të gjithë individët që kanë dhënë kontribut të veçantë në realizimin e qëllimeve dhe përcaktimeve programore të partisë.

Neni 15

Anëtarët kanë të drejtë të:



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

- marrin pjesë dhe të angazhohen në punën e partisë;
- zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e partisë;
- informohen për aktivitetet dhe veprimet e partisë;
- japin propozime, vërejtje dhe sugjerime;
- të jenë të njoftuar me aktet dhe dokumentet e aprovuara ose të projektuara nga institucionet e partisë;
- ta ruajnë nderin, dinjitetin dhe interesat e partisë;
- të paguajnë anëtarësi;

Anëtarët mbajnë përgjegjësi politike nëse me punën dhe veprimin e vet, vijnë në kundërshtim me përcaktimet programore, qëllimet dhe detyrat e partisë, si dhe me Statutin e partisë.

III. QËLLIMET DHE DETYRAT E BDI-SË

Neni 16

BDI, si parti politike, qëllimet dhe përcaktimet e veta programore do t'i realizojë konform raporteve të rregulluara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, këtij Statuti, Programit të vet punues, si dhe akteve të tjera ligjore që e rregullojnë materien nga kjo fushë.

BDI angazhohet për:

- Ruajtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit të Maqedonisë;
- Përdorim të parimeve demokratike gjatë veprimit politik;
- Shtet multietnik, në të cilin të gjithë qytetarët do të ndjehen të lirë dhe të barabartë;
- Maqedoni stabile si interes i të gjithë qytetarëve dhe si interes parësor rajonal dhe evropian;
- Integrim të Maqedonisë në strukturat euroatlantike;
- Sistem bashkëkohor ekonomik të bazuar në ekonominë e tregut dhe konkurrencës lojale, që do të rriste mirëqenien e popullatës;
- Sistem funksional social, që do të mundësonte një jetë dinjitoze për të gjithë;
- Masa institucionale për mbrojtjen e ambientit jetësor;
- Zhvillim të vlerave kulturore të cilat promovojnë komunikimin multikulturor;
- Arsim cilësor dhe të bazuar në parimet e profesionalizmit;
- Avancim të pozitës së femrës në nivelet e vendimmarrjes;



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

- Krijimin e kushteve për pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitetet sportive dhe kulturës fizike;

IV. ORGANIZIMI I BDI-SË

Neni 17

BDI, për realizimin e qëllimeve programore vepron në tërë të rritorin e Republikës së Maqedonisë.

BDI, organizohet sipas parimit territorial. Puna dhe veprimtaria e BDI-së është publike.

Anëtarësia e BDI-së, organizohet në këto forma të organizimit:

- A. Organizimi vendor Këshilli vendor;
- B. Organizimi në nivel të bashkësive lokale Nëndega
- C. Organizimi komunal Dega;
- D. Organizimi në qytetin e Shkupit – (Këshilli i degëve në Qytetin e Shkupit);
- E. Organizimi në nivel republican

IV.A. Organizimi vendor – Këshilli vendor

Neni 18

Njësia themelore organizative e BDI-së është Këshilli vendor (në tekstin e mëtutjeshëm Këshilli).

Vendimin për themelimin e Këshillit të BDI-së e sjell Kryesia e Degës së BDI-së, në sajë të iniciativës dhe kërkesës nga anëtarët e BDI-së, në mënyrë të përcaktuar me Statutin e BDI-së.

Këshilli sipas alinesë 1 të këtij neni, themelohet në tubimin themelues të anëtarëve të partisë, të cilët jetojnë në territorin për të cilin propozohet themelimi i Këshillit.

Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm mund të vendos që për shkak të numrit të vogël të anëtarëve, Nëndega të jetë formë organizative e të gjithë anëtarëve pa themelim të Këshillave.

Neni 19

Këshilli debaton për çështje të rëndësishme dhe me interes për Këshillin si dhe zbaton vendimet dhe qëndrimet e nëndegës dhe degës të cilës i përkasin.

Neni 20

Anëtarët e Këshillit, në mbledhjet zgjedhore me pjesëmarrjen e shumicës së anëtarëve, me shumicë votash zgjedhin Kryetarin e Këshillit, Kryesinë e Këshillit dhe Komisionin Mbikëqyrës, kurse në këshillat ku numri i anëtarëve është deri në 50, vetëm Kryetar, Sekretar dhe Arkëtar.

Të drejtë vote ka anëtari i cili është anëtarësuar së paku gjashtë muaj para mbajtjes së kuvendit dhe ka vendbanim në territorin e Këshillit përkatës.



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

Numri i anëtarëve të Kryesisë së Këshillit, caktohet në vendimin për themelimin të Këshillit. Si anëtar i kryesisë së Këshillit me të drejte vote janë edhe Kryetari i forumit rinor dhe forumit të gruas pranë atij Këshilli Vendor.

Mandati i kryetarit të Këshillit, anëtarëve të Kryesisë së Këshillit dhe Këshillit Mbikëqyrës zgjatë 4 (katër) vjet.

Neni 21

Kryetari konvokon dhe udhëheq me mbledhjet e Kryesisë së Këshillit si dhe kryen punë të tjera që janë në interes të Këshillit.

Kryesia e Këshillit nga radhët e veta zgjedh nënkryetar, sekretar dhe arkëtar të Këshillit.

Nënkryetari e zëvendëson Kryetarin në rast mungese dhe kryen punë të cilët ia beson Kryetari i Këshillit.

Sekretari bën përgatitjen dhe organizimin e mbledhjeve, kryen punët administrative të Këshillit, si dhe kryen punë të tjera të cilat ia beson Kryetari i Këshillit.

Arkëtarin kujdeset dhe mban evidencë për grumbullimin e anëtarësisë dhe kryen punë të tjera, të cilat ia beson Kryetari i Këshillit.

Këshilli Mbikëqyrës përbëhet prej 3 (tre) anëtarëve (kryetarit dhe dy anëtarëve) dhe ka për obligim që të mbikëqyrë punën administrative dhe materialefinanciare të organeve të Këshillit.

Për punën e vet i jep raport Kryesisë së Këshillit më së paku një herë në vit.

IV. B. Organizimi në nivel bashkësive lokale Nëndega

Neni 22

Nëndega është njësi e organizimit territorial të BDI-së, që përfshin dy e më tepër këshilla vendor në territorin e një bashkësie lokale ose me tepër bashkësive lokale.

Vendimin për themelimin e nëndegëve e sjell Kryesia e Degës së BDI-së, në saje të iniciativës dhe kërkesës së anëtarëve të BDI-së, të cilët jetojnë në territorin për të cilin propozohet themelimi i Nëndegës.

Neni 23

Organet e Nëndegës janë:

- Kuvendi i Nëndegës;
- Kryetari i Nëndegës;
- Kryesia e Nëndegës;
- Këshilli mbikëqyrës i Nëndegës.

IV. B. 1. Kuvendi i Nëndegës

Neni 24



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

Kuvendi i Nëndegës është organ më i lartë në kuadër të të drejtave dhe obligimeve të Nëndegës dhe përbëhet prej:

- Kryetarit të Nëndegës;
- Anëtarëve të Kryesisë së Nëndegës;
- Kryetarit të Forumit rinor të Nëndegës së BDI-së;
- Kryetarit të Forumit të gruas të Nëndegës së BDI-së;
- Kryetarët e Këshillave vendore;
- Nga një anëtar të zgjedhur sipas parimit të përfaqësimit “secili Këshill Vendor nga një përfaqësues”, ndërsa në raste nevojë sipas këtij parimi, mund të zgjidhen edhe më tepër përfaqësues.
- Në Kuvendin e Nëndegës marrin pjesë deputetët, ministrat, zëvendësministrat, këshilltarët dhe prefekti i komunës nga radhët e BDI-së, të asaj nëndege me të drejtë vote.
- Në Kuvendin e Nëndegës marrin pjesë edhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Nëndegës, pa të drejtë vote;

Neni 25

Kuvendi i Nëndegës thërret sipas nevojës, por jo më pak se një herë në vit.

Thirrja e Kuvendit bëhet me Vendim të Kryesisë së Nëndegës.

Kryesia e Nëndegës është e obliguar që ta thërret Kuvendin, nëse këtë e kërkojnë së paku 1/3 e kuvendarëve, ose e Kryesive të Këshillave Vendor.

Kërkesa për thirrjen e mbledhjes së Kuvendit të Nëndegës dërgohet me shkrim.

Neni 26

Kuvendi i Nëndegës e zgjedh kryetarin e Nëndegës me mandat 4-vjeçar.

Kuvendi i Nëndegës zgjedh anëtarët e Kryesisë së Nëndegës, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, me mandat 4 vjeçar, si dhe shqyrton çështje të tjera lidhur me punën e Nëndegës së BDI-së.

Kuvendi mund të vendos (të punojë) nëse në seancë marrin pjesë shumica e anëtarëve, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Marrja e vendimeve bëhet me shumicë votash të anëtarëve prezent.

IV. B. 2. Kryetari i Nëndegës

Neni 27

Kryetari i Nëndegës është organ përfaqësues dhe udhëheqës i Nëndegës.

Kryetari i Nëndegës njëkohësisht është edhe kryetar i Kryesisë së Nëndegës.

Neni 28

Kryetari i Nëndegës në suaza të kompetencave të veta:



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

- përfaqëson Nëndegën
- thërret dhe udhëheq me mbledhjet e Kryesisë;
- i nënshkruan aktet që i sjellin organet e Nëndegës dhe kujdeset për:
 - realizimin e tyre;
 - kujdeset dhe e koordinon punën e Këshillave Vendor;
 - si dhe shumë çështje të tjera që dalin nga përcaktimet programore të partisë.

Neni 29

Kryetari i Nëndegës për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Nëndegës dhe Kryetarit të Degës.

IV. B. 3. Kryesia e Nëndegës

Neni 30

Kryesia e Nëndegës përbëhet prej më së paku 7 anëtarëve dhe më së shumti 11 anëtarëve. Si anëtar i kryesisë së Nëndegës me të drejtë vote janë edhe kryetari i forumit rinor dhe forumit të gruas pranë asaj Nëndege.

Neni 31

Në kuadër të kompetencave të veta Kryesia e Nëndegës;

- realizon përcaktimet programore të BDI-së dhe vendimet e Kuvendit;
- miraton propozim-planet për të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe planet dhe programet për punë vjetore;
- përgatit raporte për punë vjetore;
- nga radhët e veta zgjedh Nënkryetar, Sekretar dhe Arkëtar të Nëndegës;
- formon komisione, grupe tjera pune dhe përcakton fushëveprimin e tyre;
- propozon kandidatë për Prefekt komune, kandidatë për këshilltarë komunal, kandidat për funksione në nivel lokal, si dhe anëtarë të trupave të ndryshme punuese në përputhje me kërkesat e Kryesisë së Degës, prioritetin e të cilëve e cakton Kryesia e Degës.
- shqyrton dhe vendos për çështjet tjera që dalin nga përcaktimet programore dhe statutore të partisë.

Neni 32

Mbledhjet e kryesisë i thërret dhe udhëheq Kryetari i Nëndegës.

Në mungesë të Kryetarit atë e zëvendëson Nënkryetari.

Nënkryetari mund të kryej edhe punë të tjera, që ia beson Kryetari i Nëndegës.

Neni 33

Sekretari i udhëheq dhe organizon dokumentacionin, administratën dhe arkivin e Nëndegës, i organizon dhe i përgatit mbledhjet e Nëndegës, të Kryesisë së Nëndegës dhe organeve tjera.



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

E përcjell zbatimin e qëndrimeve, vendimeve dhe konkluzioneve që i sjellin organet e Nëndegës, kujdeset për pronën e Nëndegës, si dhe kryen punë të tjera të cilat ia beson Kryetari i Nëndegës.

Sekretari i Nëndegës njëkohësisht udhëheq edhe me shtabin zgjedhor të Nëndegës.

Neni 34

Kryesia vendos nëse në seancë marrin pjesë, shumica e anëtarëve nga numri i përgjithshëm i saj.

Kryesia vendos në mënyrë të plotfuqishme, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Kryesia së paku një herë në vit, përgatit raport me shkrim për Kuvend të Nëndegës.

IV. B. 4. Këshilli Mbikëqyrës i Nëndegës

Neni 35

Këshilli Mbikëqyrës i Nëndegës përbëhet prej 3 (tre) anëtarëve.

Këshilli në mbledhjen e vet të parë zgjedh Kryetar.

Këshilli Mbikëqyrës, përcjell dhe kontrollon punën administrative dhe materialefinanciare të Nëndegës, kurse për punën e vet i jep raport Kuvendit të Nëndegës, më së paku një herë në vit.

IV. C. ORGANIZIMI KOMUNAL DEGA

Neni 36

Dega është njësi e organizimit më të gjerë territorial të BDI-së, që përfshin territorin e një komune.

Vendimin për themelimin e degëve e sjell Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm të BDI-së, në saje të iniciativës dhe kërkesës së anëtarëve të BDI-së, të cilët jetojnë në territorin për të cilin propozohet themelimi i degës.

Neni 37

Organet e degës janë:

1. Kuvendi i Degës;
2. Kryetari i Degës;
3. Kryesia e Degës;
4. Këshilli Mbikëqyrës.

IV.C.1. KUVENDI I DEGËS

Neni 38

Kuvendi i degës është organ më i lartë në kuadër të të drejtave dhe obligimeve të degës dhe përbëhet prej:

- Kryetarit të Degës;
- Anëtarëve të Kryesisë së Degës;
- Kryetarit të Forumit Rinor të Degës së BDI-së;



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

- Kryetarit të Forumit të Gruas të Degës së BDI-së;
- Kryetarët e Nëndegëve;

Nga një anëtar të zgjedhur sipas parimit të përfaqësimit “secili Këshill Vendor nga një përfaqësues”. Varësisht nga specifikat e degës, kryesia e degës mund të vendosë edhe përfaqesim tjetër të Këshillave, me pëlqim paraprak të Kryetarit të partisë.

Në Kuvendin e Degës marrin pjesë deputetët, ministrat, zëvendësministrat, këshilltarët dhe prefekti i komunës nga radhët e BDI-së, të asaj dege me të drejtë vote.

Në Kuvendin e Degës marrin pjesë edhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të degës, pa të drejtë vote;

Në Kuvendin Zgjedhor të Degës, anëtarët e kryesisë së vjetër të degës nuk kanë të drejtë vote, nëse nuk janë kuvendarë të zgjedhur.

Neni 39

Kuvendi i Degës thirret sipas nevojës, por së paku një herë në vit. Thirrja e kuvendit bëhet me Vendim të Kryesisë së Degës.

Kryesia e Degës është e obliguar që ta thërret Kuvendin, nëse këtë e kërkojnë së paku 1/3 e kuvendarëve, ose e kryesive të nëndegëve dhe të Këshillave Vendor.

Kërkesa për thirrjen e mbledhjes së Kuvendit të Degës dërgohet me shkrim.

Neni 40

Kuvendi i Degës me propozim të Kryetarit të Partisë Liderit, e zgjedh kryetarin e Degës me mandat 4-vjeçar.

Kuvendi i Degës zgjedh anëtarët e Kryesisë së Degës, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, me mandat 4 vjeçar, si dhe shqyrton çështje të tjera lidhur me punën e degës së BDI-së.

Kuvendi mund të vendos (të punojë) nëse në seancë marrin pjesë shumica e anëtarëve, nga numri i përgjithshëm i kuvendarëve.

Marrja e vendimeve bëhet me shumicë votash të anëtarëve prezent.

IV. C. 2. KRYETARI I DEGËS

Neni 41

Kryetari i Degës është organ përfaqësues dhe udhëheqës i Degës. Kryetari i Degës njëkohësisht është edhe Kryetar i Kryesisë së Degës.

Neni 42

Kryetari i Degës në suaza të kompetencave të veta:

- përfaqëson Degën;



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

- thërret dhe udhëheq me mbledhjet e kryesisë;
- nënshkruan aktet që i sjellin organet e Degës dhe kujdeset për realizimin e tyre;
- kujdeset dhe e koordinon punën e Nëndegëve;
- si dhe shumë çështje tjera që dalin nga përcaktimet programore të partisë.

Neni 43

Kryetari i Degës për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Degës dhe kryetarit të partisë.

IV. C. 3. KRYESIA E DEGËS

Neni 44

Kryesia e Degës është organ politik-ekzekutiv i Kuvendit të Degës, që përbëhet prej së paku 11 anëtarëve dhe më së shumti 17 anëtarëve.

Kryetari i Forunit rinor dhe Forunit të gruas janë anëtarë të Kryesisë së Degës në bazë të funksionit me të drejte vote.

Neni 45

Në kuadër të kompetencave të veta Kryesia e Degës;

- realizon përcaktimet programore të BDI-së dhe vendimet e Kuvendit;
- miraton propozim-planet për të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe planet dhe programet për punë vjetore;
- përgatit raporte për punë vjetore;
- nga radhët e veta zgjedh nënkryetar, sekretar dhe arkëtar të Degës;
- formon komisione, grupe tjera pune dhe përcakton fushëveprimin e tyre;
- propozon më së paku nga dy kandidatë për deputetë, kandidatë për prefekt komune, kandidatë për këshilltarë komunal, kandidat për funksione në nivel qendror, kandidat për funksione të qeverisjes republikane në nivel komunal dhe të qeverisjes lokale, si dhe anëtarë të trupave të ndryshme punuese në përputhje me kërkesat e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm, prioritetin e të cilëve e cakton Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm ose Kryetari i Partisë;
- shqyrton dhe vendos për çështjet tjera, që dalin nga përcaktimet programore dhe statutore të partisë.
- obligimet, të drejtat dhe kompetencat e veta i realizon në nivel të organeve komunale

Neni 46

Mbledhjet e kryesisë i thërret dhe udhëheq kryetari i Degës. Në mungesë të kryetarit atë e zëvendëson nënkryetari.

Nënkryetari mund të kryej edhe punë të tjera që ia beson kryetari i Degës.

Neni 47



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

Sekretari udhëheq dhe organizon dokumentacionin, administratën dhe arkivin e Degës, organizon dhe i përgatit mbledhjet e Degës, të Kryesisë së Degës dhe organeve të tjera.

E përcjell zbatimin e qëndrimeve, vendimeve dhe konkluzioneve që i sjellin organet e Degës, kujdeset për pronën e Degës, si dhe kryen punë të tjera, të cilat ia beson kryetari i Degës.

Sekretari i Degës njëkohësisht udhëheq edhe me Shtabin Zgjedhor të Degës.

Neni 48

Kryesia vendos nëse në seancë marrin pjesë shumica e anëtarëve nga numri i përgjithshëm i saj.

Kryesia vendos në mënyrë të plotfuqishme, me shumicën e votave të anëtarëve prezent.

Kryesia së paku një herë në vit, përgatit raport me shkrim për Kuvend të Degës.

IV.C. 4. KËSHILLI MBIKËQYRËS I DEGËS

Neni 49

Këshilli Mbiqëqyrës i Degës përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve. Këshilli në mbledhjen e vet të parë zgjedh kryetar.

Këshilli Mbiqëqyrës, përcjell dhe kontrollon punën administrative dhe materiale financiare të degës, kurse për punën e vet i jep raport Kuvendit të Degës, së paku një herë në vit.

IV.D. ORGANIZIMI NË QYTETIN E SHKUPIT (KËSHILLI I DEGËVE NË QYTETIN E SHKUPIT)

Neni 50

Në kryeqytet, BDI do të organizohet në Këshill të Degëve në qytetin e Shkupit.

Në kryeqytet, nga kuvendarë të zgjedhur nga kuvendet e Degëve, formohet Këshilli i Degëve në qytetin e Shkupit.

Për formimin e Këshillit të Shkupit, kuvendarë zgjedhin degët të cilat u takojnë komunave, që marrin pjesë në Kuvendin e Shkupit të zgjedhur në zgjedhjet lokale, në përputhje me ligjin për qytetin e Shkupit.

Numri i këshilltarëve, të cilët zgjidhen në Këshillin e degëve në qytetin e Shkupit është identik me atë të paraparë me Ligjin që e rregullon zgjedhjen në qytetin e Shkupit për Kuvendin e Shkupit që i takon qeverisjes lokale.

Neni 51

Kuvendi i Degëve në qytetin e Shkupit, obligimet dhe të drejtat i kryen në përputhje me nenet që i rregullojnë obligimet dhe të drejtat e organeve të Degës, por për qytetin e Shkupit.

Degët e Shkupit komunikojnë me Kryetarin, Këshillin dhe organet e Këshillit të qytetit të Shkupit, i cili i kryen detyrat e veta programore dhe ato të marra nga organet më të larta të partisë.



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

Kryetari dhe Organet e Këshillit të Degëve në qytetin e Shkupit, përgjigjen para Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm dhe Kryetarit të Partisë – Liderit.

IV. E. ORGANIZIMI NË NIVEL REPUBLIKAN

Neni 52

Organet e BDI-së janë:

1. Kongresi;
2. Kryetari;
3. Këshilli i Përgjithshëm;
4. Këshilli i të urtëve.

V. E. 1. KONGRESI

Neni 53

Kongresi është organ më i lartë i partisë.

Kongresi mund të jetë i rregullt dhe i jashtëzakonshëm. Kongresi i rregullt mbahet një herë në katër vjet.

Vendim për Kongres sjell Këshilli i Përgjithshëm 3 (tre) muaj para ditës së mbajtjes.

Kongres i jashtëzakonshëm thërritet nga kryetari dhe nëse atë e kërkojnë 2/3 (dy të tretat) e anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm.

Propozimi për thirrjen e kongresit, para afatit të përcaktuar me këtë Statut, duhet të përmbaj rendin e ditës me arsyetim.

Kongresi i jashtëzakonshëm konform alinesë 4 të këtij neni, konvokohet në afat prej 2(dy) muajve pas marrjes së vendimit nga ana e Këshillit të Përgjithshëm.

Neni 54

Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm të Partisë 10 (dhjetë) ditë pas caktimit të datës së mbajtjes së Kongresit, zgjedh Këshill për Përgatitjen e Kongresit.

Numrin e pjesëmarrësve në kongres, e cakton Këshilli i përgjithshëm me propozim të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm, në bazë të numrit të votave të fituara në zgjedhjet e fundit parlamentare.

Në punën e Kongresit marrin pjesë edhe anëtarët aktual të Këshillit të Përgjithshëm të BDI-së, me të drejtë vote.

Neni 55

Kongresi i BDI-së miraton me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i delegateve:



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

- programin, statutin e partisë dhe dokumente të tjera, siç janë rezolutat, deklaratat etj;
- shqyrton dhe miraton raportin për punën e partisë ndërmjet dy kongreseve;
- shqyrton dhe sjell akte dhe dokumente të tjera dhe kryen punë tjera, të nevojshme për partinë.

Neni 56

Kongresi zgjedh:

- Kryetarin e Partisë;
- anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm;

IV.E.2. KRYETARI I PARTISË

Neni 57

Kryetarin e partisë e zgjedh kongresi me vota të fshehta, nëse Kongresi nuk vendos ndryshe.

Procedura dhe kriteret e kandidimit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Përgjithshëm.

Mandati i Kryetarit të Partisë zgjat 4 (katër) vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Kryetar i partisë zgjidhet kandidati i cili fiton mbi 50% (për qind) të votave nga numri i përgjithshëm i delegateve të kongresit.

Nëse në rrethin e parë të votimit asnjë kandidat nuk e fiton besimin e mbi 50% (për qind) të delegateve, në rrethin e dytë votohet për dy kandidatët që kanë marrë më së shumti vota në rrethin e parë.

Në rrethin e dytë fiton kandidati i cili ka fituar shumicën e votave të delegateve që kanë votuar, me kusht që të kenë votuar mbi 50% (për qind) të delegateve dhe numri i votave që ka fituar kandidati të mos jetë më i vogël se 1/3 (një e treta) e numrit të përgjithshëm të delegateve të Kongresit.

Neni 58

Kryetari i partisë:

- prezanton dhe përfaqëson partinë;
- në mënyrë aktive ndikon në sendërtimin dhe valorizimin e përcaktimeve programore të partisë;
- kujdeset për realizimin e programit partiak, të Statutit dhe akteve tjera që i sjellin organet e partisë;
- në emër të partisë nënshkruan akte dhe vendime që i sjellin organet partiake;
- në emër të partisë pezullon vendimet e degëve, si dhe shpërndan Degën, Nëndegën ose Këshillin Vendor të partisë, që bie ndesh me përcaktimet e programit ose Statutin e partisë.
- në emër të partisë nënshkruan marrëveshje të karakterit ndërpartiak ose me karakter të bashkëpunimit ndërkombëtar.
- i propozon Këshillit të Përgjithshëm zgjedhjen e nënkryetarëve, Sekretarin e Përgjithshëm, Sekretarin Organizativ si dhe funksionarëve të tjerë të partisë;



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

- propozon zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm;
- për punën e vet i paraqet raport Kongresit;
- kryetari me Vendim e krijon kryesinë e ngushtë si organ kolektiv këshillëdhënës të tij;
- kryetari ka të drejtë të themelojë trup punues në funksion të realizimit të kompetencave të veta;
- për punën e tyre, trupat punues i paraqesin raport me shkrim kryetarit të partisë.

IV. E. 3. KËSHILLI I PËRGJITHSHËM

Neni 59

Këshilli i Përgjithshëm është organ më i lartë i partisë ndër-mjet dy kongreseve.

Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve 75 anëtarë që i zgjedh Kongresi i Partisë me vota të fshehta nga lista e kandidatëve, prej të cilëve 1/3 propozohen nga kryetari, kurse 2/3 nga Kongresi me mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhje.

Mënyra e propozimit, numri i anëtarëve që do të përfaqesojnë Degët në Këshillin e përgjithshëm, si dhe çështje tjera në lidhje me kandidimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit nga Kongresi do të rregullohen me Rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli i përgjithshëm.

Anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm sipas funksionit janë: Kryetari i partisë, nënkryetarët, Sekretari i Përgjithshëm, Sekretari Organizativ, anëtarët e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm, deputetët, ministrat, zv/ ministrat, kryetarët e komunave të BDI së, kryetarët e degëve, kryetari i Forumit të Gruas dhe kryetari i Forumit të Rinjve, me të drejtë vote.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës merr pjesë në punën e Këshillit të Përgjithshëm pa të drejtë vote.

Neni 60

Kompetencat e Këshillit të Përgjithshëm janë:

- verifikimi i Programit politik dhe Statutit të partisë;
- cakton numrin e nënkryetarëve si dhe bën zgjedhjen dhe shkarkimin e nënkryetarëve, Sekretarit të Përgjithshëm, Sekretarit Organizativ dhe anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të BDI-së;
- përkujdeset për realizimin e detyrave të përcaktuara në Kongres;
- shqyrton dhe miraton raportet e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm;
- shqyrton dhe propozon çështje të ndryshme të cilat duhet t'i shqyrtojë Kongresi;
- shqyrton dhe miraton nevojën e bashkëpunimit për çështje konkrete programore me partitë e tjera politike;
- verifikon listën e kandidatëve për deputetë, si dhe kandidatët për funksionet tjera;
- shqyrton gjendjen materiale-financiare dhe aprovon raportin financiar të partisë;
- sjell vendim për caktimin e datës së mbajtjes së Kongresit të Partisë;
- formon trupa të nevojshme pune për përgatitjen e kongresit;
- sipas nevojës vendos edhe për çështje tjera të lidhura me partinë.

Neni 61



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

Këshilli i Përgjithshëm mund të formojë komisione apo sekretariate për detyra konkrete si:

- Komisioni për zhvillim dhe hulumtime strategjike;
- Komisioni për çështje ekonomike dhe financiare;
- Komisioni për veprimtari informative;
- Komisioni për marrëdhënie ndërkombëtare;
- Komisioni për çështje kadrovike;
- Komisioni për bashkëpunim ndërpartiak;
- Komisioni për çështje juridike;
- Komisioni për arsim, shkencë dhe kulturë;
- Komisioni për shëndetësi dhe çështje sociale etj.

Sipas nevojës Këshilli i Përgjithshëm mund të formojë edhe komisione të tjera.

Neni 62

Këshilli i Përgjithshëm mban mbledhje sipas nevojës.

Mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm e thërret dhe me të udhëheq Kryetari i Partisë.

Mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm thirren, së paku një herë në 6(gjashtë) muaj.

Mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm thirren, së paku 10-(dhjetë) ditë para mbajtjes.

Këshilli i Përgjithshëm sjell vendime dhe akte nga fushëveprimi i vet. Këshilli i Përgjithshëm vendimet e veta i sjellë me shumicë votash, nga anëtarët e pranishëm.

IV. E. 3. 1. Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm

Neni 63

Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm është organ politik-ekzekutiv i Këshillit të Përgjithshëm të Partisë.

Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm të Partisë numëron 33 anëtarë.

Neni 64

Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm mban mbledhje sipas nevojës, por së paku një herë në muaj.

Mbledhjet i thërret dhe me to udhëheq kryetari i partisë.

Neni 65

Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm i përcjell dhe i miraton zgjedhjet për Kryesinë e Degëve.

Në mbledhjet zgjedhore të Degëve detyrimisht marrin pjesë anëtarët e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm nga ajo degë dhe anëtarë të kryesisë jashtë degës përkatëse.

Neni 66



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm me propozim të Kryetarit të Partisë, duke pasur parasysh propozimet e degëve, përpilon listën e kandidatëve për deputet, të cilën ia paraqet për verifikim Këshillit të Përgjithshëm.

Me propozim të kryetarit, Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm cakton bartës të funksioneve tjera shtetërore, si dhe personin i cili do të udhëheq me punët financiare të partisë.

Kryesia për punën e vet i jep llogari Këshillit të Përgjithshëm.

IV. E. 3. 2. Nënkyetarët

Neni 67

Këshilli i Përgjithshëm me propozim të kryetarit zgjedh nënkyetarët e Këshillit të Përgjithshëm.

Nënkyetarët zgjidhen me shumicë të votave, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm.

Mandati i nënkyetarëve zgjat 4 (katër) vjet.

Zgjedhja e nënkyetarëve bëhet me vota të fshehta, nëse Këshilli i Përgjithshëm nuk vendos ndryshe.

Nënkyetarë mund të propozojnë edhe 1/3 (një e treta) e anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm.

Kryetari i partisë duhet të japë pëlqimin për kandidatin për nënkyetarë, nëse ai propozohet nga anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm.

Neni 68

Propozimin për shkarkim të nënkyetarëve, mund ta iniciojnë kryetari i partisë dhe 1/3 (një e treta) e anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm. Nënkyetarët mund të shkarkohen nëse për shkarkim votojnë mbi 50% (për qind) të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm.

Neni 69

Nënkyetarët mund ta zëvendësojnë kryetarin në rast nevojë dhe kryejnë punë të caktuar në parti, për të cilat i autorizon Kryetari i partisë.

IV. E. 3. 3. SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Neni 70

Sekretarin e Përgjithshëm e zgjedh Këshilli i Përgjithshëm me propozim të kryetarit të partisë, me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm.

Kandidat për Sekretar të Përgjithshëm mund të propozojnë edhe 1/3 (një e treta) e anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm me kusht që kryetari i partisë të japë pëlqim.

Mandati i Sekretarit të Përgjithshëm zgjat 4 (katër) vjet, me të drejtë rizgjedhje.

Propozim për shkarkim të Sekretarit të Përgjithshëm mund të paraqes kryetari i partisë dhe 1/3 e anëtarëve të këshillit.



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

Sekretari i Përgjithshëm shkarkohet, nëse për shkarkimin e tij votojnë mbi 50% (për qind) të numrit të anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm.

Vendimi për zgjedhjen apo shkarkim sillet me vota të fshehta, nëse këshilli nuk vendos ndryshe.

Neni 71

Sekretari i Përgjithshëm është anëtar i Këshillit të Përgjithshëm dhe i Kryesisë dhe merr pjesë në punën e këtyre dy organeve.

Ai udhëheq dhe organizon dokumentacionin dhe arkivin e partisë.

I organizon dhe përgatit mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm, të Kryesisë, dhe të Kongresit.

E përcjell zbatimin e qëndrimeve, vendimeve dhe konkluzioneve që sjellin organet e partisë.

Organizon dhe kujdeset për funksionimin e administratës.

Si dhe kryen punë tjera në parti për të cilat e autorizon Kryetari i partisë.

IV. E. 3. 4. Sekretari Organizativ

Neni 72

Sekretarin Organizativ e zgjedh Këshilli i Përgjithshëm me propozim të kryetarit të partisë, me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm.

Kandidat për Sekretar Organizativ mund të propozojnë edhe 1/3 (një e treta) e anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm me kusht që kryetari i partisë të japë pëlqim.

Mandati i Sekretarit Organizativ zgjat 4 (katër) vjet, me të drejtë rizgjedhje.

Propozim për shkarkim të Sekretarit Organizativ mund të paraqesë kryetari i partisë dhe 1/3 e anëtarëve të këshillit.

Sekretari Organizativ shkarkohet nëse për shkarkimin e tij, votojnë mbi 50% (për qind) të numrit të anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm.

Vendimi për zgjedhjen apo shkarkim sillet me vota të fshehta, nëse këshilli nuk vendos ndryshe.

Neni 73

Sekretari Organizativ është anëtar i Këshillit të Përgjithshëm dhe i Kryesisë, si dhe merr pjesë në punën e këtyre dy organeve.

Sekretari Organizativ kryen punë organizative dhe punë të tjera në parti, për të cilat e autorizon kryetari i partisë.

IV.E.4. Këshilli i të Urtëve

Neni 74



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

Këshilli i të Urtëve është organ orientues, këshilldhënës dhe mbikqyrës i Bashkimit Demokratik për Integrim.

Këshilli i të Urtëve përbëhet prej se paku 7 anëtarëve me mandat të përjetshëm të emëruar nga Kryetari i parë i Bashkimit Demokratik për Integrim.

Në rast të vdekjes, anëtarët zëvendësohen me propozim të anëtarëve të gjallë të Këshillit të të Urtëve dhe vendimi merret me konsensus.

Këshilli i të urtëve i merr vendimet me konsensus midis anëtarëve të këshillit.

Vendimet e Këshillit të të Urtëve janë obligative dhe përfundimtare për të gjitha organet e Bashkimit Demokratik për Integrim.

Neni 75

Kompetencat e Këshillit të të Urtëve të BDI-së janë:

- jep pëlqim paraprak për çdo iniciativë për ndryshim të orientimit strategjik dhe programor të partisë si dhe të statutit të partisë;
- mbikqyr punën e organeve të partisë;
- kujdesët për pronën, trashëgiminë dhe asetet e partisë;
- jep pëlqim për kandidatët për Kryetarit të partisë;
- jep vlerësim për propozimet për deputetët, ministra dhe kryetar komunash nga Bashkimi Demokratik për Integrim;
- jep vlerësim për nevojën e bashkëpunimit me partitë e tjera politike;
- jep vlerësim për koalicionet parazgjedhore dhe paszgjedhore;
- vlerëson realizimin e programit partiak, të statutit dhe akteve tjera që i sjellin organet e partisë;
- pezullon vendimet e këshillit të përgjithshëm, kryesisë së këshillit të përgjithshëm, degëve, si dhe këshillit mbikqyrës të partisë që bien ndesh me përcaktimet e programit ose statutin e partisë.
- sipas nevojës vendos edhe për çështje tjera të lidhura me partinë.

Neni 76

Këshilli i të Urtëve mban mbledhje sipas nevojës.

Mbledhjen e Këshillit të të Urtëve e thërret dhe me të udhëheq kryetari i parë i partisë.

Mbledhjet e Këshillit të të Urtëve thirren më së paku 10-(dhjetë) ditë para mbajtjes.

Këshilli i të Urtëve sjell vendime dhe akte nga fushëveprimi i vet.

V. KËSHILLI MBIKËQYRËS I BDI-SË

Neni 77

Këshilli Mbikëqyrës bën mbikëqyrjen e akteve dhe vendimeve të miratuara nga organet e partisë, bën mbikëqyrjen e gjendjes materiale-financiare të partisë, vlerëson aktet juridike të partisë nëse janë në harmoni me Statutin, bën interpretimin e Statutit ndërmjet seancave të kongresit, dhe për punën e vet sjell Rregullore për punë.



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

Këshilli Mbikëqyrës ka 5 (pesë) anëtarë që i zgjedhë Këshilli i Përgjithshëm me vota të fshehta, me propozim të kryetarit të partisë me mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës zgjidhet kandidati që ka fituar shumicën e votave, nga anëtarë prezent të Këshillit të Përgjithshëm.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës në afat prej 10 ditësh prej zgjedhjes, nga radhët e veta zgjedhin kryetar dhe nënkryetar.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jenë anëtarë të organeve tjera partiake.

Për punën e vetë përgatisin raport me shkrim dhe ia paraqesin Këshillit të Përgjithshëm, së paku një herë në vit.

VI. PËRFAQËSUESIT E ZGJEDHUR

Neni 78

Deputetët e BDI-së në Kuvendin e R.M-së, organizohen në grup parlamentar.

Grupi parlamentar, nga radhët e veta me propozim të Kryetarit të partisë, zgjedh koordinator dhe zëvendës me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Grupi parlamentar i BDI-së, gjatë punës së vet është i obliguar që të veprojë në përputhje me përcaktimet programore, qëndrimet e partisë, Statutit të saj dhe qëndrimet politike të Kryetarit të partisë.

Për këtë qëllim, ai është i obliguar që të konsultohet me organet e partisë.

Neni 79

Këshilltarët e BDI-së, në kuvendet komunale organizohen në grup këshilltarësh.

Grupi i këshilltarëve gjatë punës së vet është i obliguar që të veprojë në përputhje me përcaktimet programore të partisë, qëndrimeve, Statutit të saj dhe qëndrimet e Kryetarit të Degës.

Për këtë qëllim ai obligohet të konsultohet me organet e partisë.

Grupi i këshilltarëve, nga radhët e veta me propozim të Kryetarit të Degës, zgjedh koordinator dhe zëvendës me shumicë votash, nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve.

VII. FORUMI I RINISË DHE FORUMI I GRUAS

Neni 80

Për funksionimin më të suksesshëm, partia në radhët e veta themelon Forumin e Rinisë dhe Forumin e Gruas.

Vendim për themelimin e Forumit të Rinisë dhe Forumit të Gruas, sjell Këshilli i Përgjithshëm.

Për funksionimin dhe veprimin e Forumit të Rinisë dhe Forumit të Gruas, zgjedhjeve dhe organizimit, forumet i propozojnë rregullore të ndryshme, akte dhe vendime të nevojshme për miratim Këshillit të Përgjithshëm.



VIII. QËNDRA ANALITIKO-KËRKIMOR PARTIAK I BDI-SË

Neni 81

BDI si organizat e brëndëshme formon QENDRËN ANALITIKO-KËRKIMOR PARTIAK TË BDI-më (QAKP), për ndërtimin e platformës në të cilën duhet të tregoj struktur dhe depat të kualifikuar në harmoni me Ligjin për Qendër analitiko-kërkimor partiak.

Neni 82

QAKP i BDI bën organizimin e tribina, debateve, seminarëve, punëtorive, hulmitim të mendimeve publike, publikim të studimeve, evaluim të politikave të Bdi, aktivitete ndërpartikate dhe ndërkombëtare sidhe aktivitete tjera në sferën e hulumtimeve në harmoni me planifikimin politiko-strategjikë të BDI.

Kushtet tekniko-hapsinorë për funksionimin e qendrës i siguron BDI.

IX. FINANCIMI

Neni 83

Burimet për financimin e BDI-së dhe të dalat e saja janë publike dhe transparente.

Mjetet financiare për veprimin e vet, BDI i siguron nga burimet publike dhe private të financimit.

Burimet publike janë mjetet të parapara nga Buxheti i R.M-së dhe buxhetet e komunave dhe qytetit të Shkupit.

Burimet private të financimit llogariten:

- taksa e anëtarësisë;
- donacionet;
- dhuratat;
- dotacionet;
- sponzorimet;
- legatet;
- shitja e materialeve promovuese dhe propaganduese, si dhe nga burimet e tjera në përputhje me Ligjin mbi financimin e partive politike.

Për realizimin e veprimtarisë së saj, BDI ka në pronësi hapësira për punë, paisje, materiale, mjete transporti, si dhe mjete të tjera të nevojshme për realizimin e qëllimeve dhe aktiviteteve të përcaktuara në statutin e partisë dhe në ligj.

Neni 84

Taksa e anëtarësisë caktohet me vendim të posaçëm, që nxirret nga Këshilli i Përgjithshëm i BDI-së, me kusht që shuma e taksës në periudhën njëvjeçare për secilin anëtarë, nuk guxon të jetë më e lartë se një rrogë mesatare në R.M gjatë vitit paraprak.

Anëtarët të cilët bartin mandate dhe funksione nga BDI, paguajnë kontribute plotësuese të caktuara me Vendim të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm.



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

Neni 85

Të hyrat dhe të dalat financiare, përcaktohen me buxhetin e partisë. Gjatë vitit, Këshilli i Përgjithshëm mund të bëjë ndryshime dhe plotësime të buxhetit. Për të hyrat dhe të dalat mbahet evidencë financiare.

Për veprimtarinë e saj financiare dhe materiale, BDI i kryen të gjitha veprimet e kontabilitetit dhe realizon kontrollin e brendshëm në përputhje me ligjin.

BDI më së voni deri më 31 mars përgatit raport financiar vjetor për vitin paraprak, në përputhje me ligjin. Raporti përmban veprimtarinë financiare të llogarisë së partisë, si edhe nënllogaritë e organeve lokale si edhe nënllogarinë e qendrës kërkimore dhe analitike të partisë. Raporti financiar vjetor përmban të ardhurat gjithsej si edhe totalin e shpenzimeve. Raportin vjetor financiar partia do ta shpall në ueb faqen e partisë, në një gazetë ditore dhe në "Gazetën zyrtare të R.M-së".

X. DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 86

Në kushte të jashtëzakonshme, kur bëhet e pamundshme të tubohet Kongresi, Kryesia dhe Këshilli i Përgjithshëm, kompetencat e tyre i merr Këshilli i të Urtëve.

XI. PUSHIMI I PUNËS SË PARTISË

Neni 87

Partia pushon së ekzistuari:

- nëse numri i anëtarëve bie nën numrin e përcaktuar ligjor për themelimin e saj.
- nëse puna e saj ndërpritet nga organet e Gjykatës Themelore ose Gjyqit Kushtetues.
- nëse Kongresi me dy të tretat e votave të numrit të përgjithshëm të delegatëve dhe me pëlqim të Këshillit të të Urtëve sjell vendim për pushimin e punës së partisë.

Neni 88

Në rast të pushimit të punës së partisë, Këshilli i të Urtëve vendos mbi pronën e përgjithshme të Bashkimit Demokratik për Integrim.

XII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 89

Të gjitha çështjet që nuk janë përfshirë në këtë statut Këshilli i Përgjithshëm do t'i rregullojë nëpërmjet akteve dhe vendimeve konform ligjeve dhe këtij statuti me pëlqimin e Këshillit të të Urtëve.

Neni 90

Iniciativë për ndryshime dhe plotësime të statutit mund të paraqesin: Kryetari i Partisë, Këshilli mbikqyrës, Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm dhe Këshilli i të Urtëve.

Iniciativat me propozimet konkrete, në formë të shkruar i paraqiten Këshillit të përgjithshëm, i cili vendos me pëlqimin e Këshillit të të Urtëve.



BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

Neni 91

Të gjitha aktet e përgjithshme të partisë duhet të harmonizohen me dispozitat e këtij Statuti në afat prej 6 muajve, pas miratimit të këtij Statuti.

Neni 92

Ky Statut hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kongresi.

Bashkimit Demokratik për Integrim

Kryetar:

Ali Ahmeti